

VENDIM
Nr. 15, datë 13.6.2012

PËR RINOVIM LICENCE SHA UJËSJELLËS TROPOJË

Në mbështetje të nenit 14 pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë...”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe teknik operatorit sh.a. ujësjellës Tropojë me:

Drejtues ligjor: z. Bajram Rustem Gjongecaj

Drejtues teknik : znj. Feride Rexhep Mustafa

2. Operatori sh.a. Ujësjellës Tropojë autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:

Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është bashkia Bajram Curri, komunat: Margegaj, Bujan, Llugaj.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare, deri në datë 13.6.2016.

KRYETARI
Avni Dervishi